

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Kostal Betajligungsgezellshaft 2 mbH, Gjermani do të fitoj kontroll të pavarur mbi Kompleo Çarxhing Solushns AG, Gjermani**

**(lënda nr. 08-77/2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 12.05.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me anë të së cilës **Kostal Betajligungsgezellshaft 2 mbH** (Kostal Beteiligungsgesellschaft 2 mbH), me adresë të regjistruar në An der Belmerai 10, 58513 Lidenshajn, Gjermani, do të fitojë kontroll të pavarur mbi **Kompleo Çarxhing Solushns AG** (Compleo Charging Solutions AG), me seli të regjistruar në Ecesstrase 8 44379 Dortmund, Gjermani.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

Përqendrimi në fjalë i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Kostal Betajligungsgezellshaft 2 mbH së bashku me shoqëritë e saj të varura nën kontroll të përcaktuar si: "**KOSTAL**" ose "**Grupi KOSTAL**", mbi pjesë të operacioneve të biznesit dhe mjeteve të **Kompleo Çarxhing Solushns AG** së bashku me shoqëritë e saj të varura nën kontroll të përcaktuar si: "**Kompleo**".

Biznesi i synuar përfshin biznesin e softuerit të Kompleo dhe një pjesë të madhe të biznesit të harduerit të Kompleo.

KOSTAL është një kompani familjare me seli në Lidenshtajn, është një furnizues ndërkombëtar i zgjidhjeve elektronike, elektromekanike dhe mekatronike për një gamë të gjerë të automobilave dhe përdorimeve të tjera industriale. Kompania punëson rreth 19,000 njerëz në 21 vende në 53 lokacione.

KOSTAL është i ndarë në katër reparte:

- 1- Kostal- elektrikë për makina (KOSTAL Automotive Electrics),
- 2- Kostal -elektrikë për industri (KOSTAL Industrial Electrics),
- 3- Kostal-sistemet e kontaktit (KOSTAL Contact Systems) dhe
- 4- SOMA-testim inxhinierik (SOMA Test Engineering).

Transaksioni i referohet kryesisht repartit të elektrikes për industrinë, fushat kryesore të biznesit të të cilave janë fotovoltaiçet, kontrollet e makinës dhe elektronika për matje dhe kontroll.

Portofoli i produkteve përfshin solar, bateri dhe inverter hibridë, një pajisje matës inteligjente si një aksesori për matjen dhe kontrollin e konsumit të energjisë personale dhe softuer të përshtatshëm për monitorimin e fotovoltaiçëve.

KOSTAL ka një shoqëri të varur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

KOSTAL MAKEDONIA SHPKNJ Ohër (me seli në f. Kosel 6000, Ohër dhe aktiviteti i regjistruar 29.31 - Prodhim i pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete), e cila ka një fabrikë prodhuese në Ohër.

Kompleo është një kompani e listuar në bursën e Frankfurtit, me seli në Dortmund, Gjermani. Është një ofrues shërbimi gjithëpërfshirës i harduerit dhe softuerit për teknologjitë e karikimit të automjeteve elektrike.

Portofoli i produkteve harduerike përfshin zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarja e rrymës alternative (AC) dhe rrymës direkte (DC), stacioneve të karikimit publik dhe gjysmë publik.

Në këtë drejtim, Compleo ofron stacione karikimi standard DC, stacione të karikimit të shpejtë DC dhe (që pritet të lançohet deri në fund të këtij viti) një stacion karikimi ultra të shpejtë.

**Kompleo** nuk është e regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Sipas parashtruesve të njoftimit, tregu relevant i mallrave për përqendrimin e njoftuar mund të përkufizohet si treg për shërbime ose softuer për administrimin dhe përdorimin e pikave gjysmë publike dhe publike të karikimit për automjetet elektrike, pa pasur nevojë për segmentim të mëtejshëm.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

31.05. 2023

Shkup